



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

Nr_2124/2_Prot.

Klos më 11/08/2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje ushqimesh për kopshtin për vitin shkollor 2026-2027”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 15894210-6
Ushqime për shkollë.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,743 (Tetë mijë e Shtashtëqind e dyzetë e tre) lekë pa t.v.sh, ku fondi limit nënkupton totalin e çmimeve të përlogaritura për njësi për çdo artikull, referuar pikës 7.3 të Udhëzimit Nr. 6, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” të Agjencisë së Prokurimit Publik.

**Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër për 12 muaj
1,150,000 lekë pa tvsh.**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 muaj.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Agjencia e Funksioneve të Patransferueshme Klos**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të L.PP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Liçencë, kategoria II.1.A(1) “Per prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez”, e cila te perfshije te pakten nje nga artikujt objekt prokurimi.

Liçencë, kategoria II.1.B, Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëzit).

Shenim: Nuk lejohet perdorimi i licenses se nje operatori tjetër ekonomik (Rekomandim i përbashkët i APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenës dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet e viteve , tre viteve të fundit 2023,2024,2025, të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

2.2.2. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare nga data e zhvillimit të tenderit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jete jo me e vogel se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, te LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin 2026, për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d). Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2024, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 si dhe vendimeve respektive të Këshillave Bashkiakë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e hapur e thjeshtuar, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar

2.3.2 - Vërtetim për numrin mesatar të punonjësve për periudhën kohore 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar, jo më i vogël se 5 punonjës, i vërtetuar nga organet tatimore për të mundësuar realizimin e kontratës me sukses.

Ne lidhje me kete pike te paraqitet: Vertetim nga administrata tatimore per numrin e punonjesve te siguruar si dhe listepagesat per secilin muaj.

Disponimi i punonjesve si me siper do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhenenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

2.3.3 – Operatori ekonomik pjesëmarrës të paraqesë raport analize për produktin buke të leshuar jo me pare se 3 muaj nga hapja e ofertave dhe të leshuar nga laboratore të licensuar dhe akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme, të lëshuara nga Institucioni përkatës i akreditimit:

Iso 22000:2018 ose ekuivalente me të

ISO 9001:2015 ose ekuivalente me të

Certifikatat duhet të jenë në fuqi, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës dhe të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Kjo kërkesë dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.3.5 Ofertuesi duhet të disponojë **magazinë ushqimore dhe ambiente frigoriferike** në pronësi ose në përdorim sipas kontratës noteriale të pajisur me llicencë II.1.B, akt miratim higjieno sanitar, raport analizën e ujit të rrjetit, certifikatën e mbrojtjes ndaj zjarrit, certifikatën e dezinfektimit 3D si dhe foto të ambientit të ushtrimit të aktivitetit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë

të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit

2.3.5 Furre buke në pronësi ose në përdorim ose kontrate furnizimi sipas kontratës noteriale, te pajisur me leje higjieno sanitare, license QKL me kodin II.1.A.(1), certifikaten e dezinfektimit 3D, certifikaten e mbrojtjes nga zjarri si dhe raport analizen e ujit të rrjetit. Për produktin e mesipër në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi/përdorim duhet që të vertetojë me kontrate furnizimi të zyrtarizuar me një subjekt prodhues e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në pikën 5 /ç të nenit 40 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: 5. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.*

Me anë të këtij kriteri AK kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike (furre buke ose ambiente të përshtatshme për magazinimin e bukes) për të përmbushur me sukses kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, nisur edhe nga natyra e produktit, që duhet të ruhet në kushte të përshtatshme higjieno-sanitare dhe tekniko-teknologjike me qëllim që të garantojnë sigurinë e produktit buke.

2.3.6 Njësi prodhimi bulmeti në pronësi ose përdorim ose kontrate furnizimi sipas kontratës noteriale, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, te pajisur me: leje higjieno sanitare, Leje mjedisore me kodin III.1.B (për trajtimin dhe përpunimin e qumështit), License lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB) me kodin II.1.A.(1) dhe II.1.B si dhe Certifikaten e dezinfektimit 3D. Për produktin e mesipër në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi/përdorim duhet që të vertetojë me kontrate furnizimi të zyrtarizuar e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në pikën 5 /ç të nenit 40 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: 5. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.*

Me anë të këtij kriteri AK kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike (furre buke ose ambiente të përshtatshme për magazinimin e bukes) për të përmbushur me sukses kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e

objektit të prokurimit, nisur edhe nga natyra e produktit, që duhet të ruhet në kushte të përshtatshme higjeno-sanitare dhe tekniko-teknologjike me qëllim që të garantojnë sigurinë e produktit buke.

2.3.7 Thertore në pronesi ose përdorim ose kontratë furnizimi sipas kontratës noteriale të pajisur me: leje higjeno sanitare, Leje mjedisore me kodin III.1.B (therje kafshesh), License lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) me kodin II.1.A.(1) (thertore). Për thertoren të paraqitet vertetim nga AKU që thertorja është funksionale (në kuader të nismave qeveritare në këtë fushë). Për produktin e mesipër në rastin kur operatori nuk e ka në pronesi/përdorim duhet që të vertetojë me kontratë furnizimi të zyrtarizuar e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në pikën 5 /ç të nenit 40 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: 5. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit*, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Me anë të këtij kriteri AK kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike (furre buke ose ambiente të përshtatshme për magazinimin e bukes) për të përmbushur me sukses kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, nisur edhe nga natyra e produktit, që duhet të ruhet në kushte të përshtatshme higjeno-sanitare dhe tekniko-teknologjike me qëllim që të garantojnë sigurinë e produktit buke.

2.3.8 - Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) mjete transporti, nga të cilat 1 (një) frigoriferike ATV për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi apo të marrë me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës (certifikatë pronesie ose kontratë qeraje noteriale) dhe të shoqëruar me lejen higjeno-sanitare, leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit, certifikatë transporti (të paraqitet automjeti i cili pajiset me këtë certifikatë sipas legjislacionit në fuqi), librezat shëndetësore së bashku me raportet mjekoligjore si dhe lejet e drejtimit të drejtuesve të mjeteve.

Disponimi i automjeteve do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e transportit të ushqimeve për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

2.3.9 Në respektim dhe zbatim të rekomandimeve të APP dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit me nr. 10181 prot, datë 19.11.2018 subjekti ofertues **duhet të paraqesë vetëdeklarim**, ku të

deklarojë se mjeti frigoriferik për kryerjen e furnizimit të ushqimeve objekt i kësaj procedure, kanë rregjister perkates per monitorimin e temperatures sipas Udhëzimit të Ministrisë së Bujqësisë nr.22, datë 25.11.2010 ” Per kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te higjenes per stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor”*Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari pas procesit te vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e plotë prane AK ne perputhje me nenin 26, pika 6, paragrafi 1, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar me VKM nr.710, date 24.11.2021.*

Argumentimi:*Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik””Autoriteti/entikontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objekti tqë prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*

I. Argumentimi ispecifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë vendosur në bazë të kërkesës për ushqime per cerdhen dhe kopeshtin te Sektorit të Arsim Kultures dhe dokumentacionit bashkelidhur saj, si dhe ne perputhje me Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 4, pika 38/b:“*Specifikime teknike” janë: b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve,specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësitë kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, dukei përfshirëedhekërkesat relevantepër produktin nëraport meemërtimin metë cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë, nenin 36 te ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar: Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

Specifikimet teknike jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor, bashkengjitur DST ne SPE. Kriteret e vecanta te kualifikimit jane hartuar nga specialisti i fushes pjese e njesise se prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme os të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njësia e Prokurimit